



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 6 qershor 2013

Numri i lëndës: 2012-18

Hamdi Sogojeva

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 6 qershor 2013, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMENIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit të datës 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 9 nëntor 2012.

II. FAKTET

2. Më 1 tetor 2004, parashtruesi i ankesës ishte punësuar nga Korporata Energjetike e Kosovës ("KEK-u", Kompani Energjetike e Kosovës). Ai ka punuar aty si vozitës kamioni.
3. Në një datë të pasaktësuar në vitin 2006, parashtruesi i ankesës ishte larguar nga puna.

III. ANKESAT

4. Parashtruesi i ankesës supozon se ai ishte larguar nga KEK-ut në mënyrë të padrejtë dhe kërkon të rikthehet në pozitën e tij.

IV. LIGJI

5. Para shqyrtimit të meritave të ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
6. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganave.
7. Paneli vëren se ankesa e parashtruesit të ankesës, në thelb, ka të bëjë me një kontest punësimi në mes të tij dhe ish punëdhënësit të tij, KEK-ut.
8. Del se çështjet e ngritura nga parashtruesi i ankesës nuk hyjnë në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë. Si pasojë ato janë jashtë mandatit të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të Rregullores së vet të Punës dhe të OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë (krahaso lëndën nr. 2011-17, *Faik Azemi kundër EULEX-it*, paragrafi 3).

PËR KËTO ARSYE

Paneli njëzëri konsideron se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, konstaton se kjo ankesë është e pabazuar sipas nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës, dhe

SHPALL KËTË ANKESË TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese